

**STATUTI I**  
**“SQUARE” SHPK**

***I. THEMELIMI***

**Neni 1**  
**Ortakët**

- 1.1 Shoqëria “Square” SHPK (“Shoqëria”) themelohet nga ortakët më poshtë:
- (a) **Znj. Alma Enesi**, shtetase shqiptare, lindur në Elbasan, më 07.06.1978, mbajtëse e pasaportës nr. BB1445459 dhe me nr. personal H85607058Q;
- (b) **Z. Andi Prenga**, shtetas britanik, lindur në Bujanovc, më 25.10.1985, mbajtës i pasaportës nr. 543239354.
- 1.2 Përgjegjësia e ortakëve është e kufizuar në përpjestim me kontributin e tyre në kapital i cili përfaqësohet në kuota.

***II. EMRI, SELIA, FORMA LIGJORE, KAPITALI***

**Neni 2**  
**Emri**

- 2.1 Emri i plotë i shoqërisë që do të përdoret në dokumentacionin zyrtar është “SQUARE” SHPK.

**Neni 3**  
**Forma ligjore**

- 3.1 Shoqëria themelohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (“Ligji Tregtar”)
- 3.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjeter ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4**  
**Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin e Shoqërisë Tregtare dhe çdo dispozitë tjeter të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

**Neni 5**



### **Kohëzgjatja e Veprimtarisë**

- 5.1 Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

#### **Neni 6 Selia dhe Degët**

- 6.1 Selia e Shoqërisë është në "Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2 - Blloku 2, Shkalla 3, Kati 2, Ap. E, Tirane, Shqiperi, 1020".
- 6.2 Administratori mund të krijojë NIPT-e sekondare të Shoqërisë në Shqipëri, në përputhje me nevojat e Shoqërisë.

#### **Neni 7 Objekti**

- 7.1 Objekti i Shoqërisë është importi, eksporti, marketimi, tregtimi, shitja (me shumicë dhe pakicë) dhe shpërndarja e produkteve kozmetike marka për tregun e gjërë. Për këtë qëllim, Shoqeria do të kryejë cdo veprimtari të shitjes së produkteve kozmetike të tilla por jo vetëm si kremëra, locione, parfume, fragrance dhe produkte të tjera të bukurisë si reklamimi, shpërndarja dhe si importues, eksportues, tregtues dhe agjent shitjeje të këtyré produkteve. Për më tepër, Shoqeria do të ushtrojë çdo veprimtari tregtare që lidhet direkt ose indirekt me objektin e mësiperme.
- 7.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

#### **Neni 8 Kapitali**

- 8.1 Kapitali fillestari i shoqërisë është 100 Lekë.
- 8.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 2 kuota me vlerë nominale 50 Lekë secila.
- 8.3 Kuotat do të mbahen nga ortakët sipas ndarjes së mëposhtme:
- Znj. Alma Enesi** zotëron 50% të kapitalit të Shoqërisë;
  - Z. Andi Prenga** zotëron 50% të kapitalit të Shoqërisë.

#### **Neni 9 Transferimi i pjesëve të kapitalit / Kufizimet mbi transferimin**

- 9.1. Ortakët bien dakort që 3 vite pas regjistrimit të Shoqërisë, ata nuk mund t'i shesin kuotat tek palë të treta jashtë ortakërisë, por kuotat janë lirshëm të transferueshme midis ortakëve gjatë kësaj periudhe. Çmimi i shitjes në këtë rast do të jetë i barabartë me kontributin në para të ortakut shitës në SHPK.

nëpërmjet rritjes së kapitalit, paradhënie/hua ortaku ose cdo formë tjetër të lejuar kontributi regjistruar rregullisht në librat kontabël të Shoqërisë.

- 9.2. Pas kalimit të afatit të mësipërm, cdo ortak mund të shesë kuotën e tij në Shoqëri (vetëm plotësisht dhe jo pjesërisht) me kusht që së pari t'i ofrojë ortakut tjetër me shkrim (duke përfshirë edhe postën elektronike) të drejtën e parablerjes ("Njoftimi i Transferimit"). Njoftimi i Transferimit do të përbajë detajet e blerësit të ofruar dhe çmimin e blerjes. Brenda njëzet (20) ditëve kalendarike nga marrja e Njoftimit të Transferimit, ortaku tjetër duhet të informojë ortakun shitës nëse dëshiron të ushtrojë të drejtën e parablerjes, në të cilin rast, çmimi i blerjes së kuotës në shitje do të jetë i barabartë me kontributin në para të ortakut shitës në Shoqëri qoftë përmes huasë apo kapitalit plus të ardhurat operative të Shoqërisë në dy vitet paraardhëse fiskale të veprimtarisë së saj. Realizimi i shitjes dhe pagesa e çmimit të blerjes në këtë rast ("Realizimi"), duhet të bëhet ndodhë brenda tre (3) muajve nga njoftimi i ortakut blerës.
- 9.3. Nëse ortaku nuk jep njoftim në bazë të pikës 9.2, ose shitja nuk ka përfunduar brenda 3 (tre) muajve siç parashikohet në pikën 9.2, ortaku shitës ka të drejtë të transferojë kuotat tek pala e tretë e identifikuar në Njoftimin e Transferimit, me kusht që ky transferim të bëhet:
  - 9.3.1. me një çmim jo më të vogël se ai i përcaktuar në Njoftimin e Transferimit ose,
  - 9.3.2. përndryshe me kushte jo më të favorshme se ato të specifikuara në Njoftimin e Transferimit.
- 9.4. Kuota e transferuar do të kalojë me të të drejtat takuese ose që mund t'i takojnë në të ardhmen (duke përfshirë, veçanërisht, të drejtën për të marrë të gjitha dividentët dhe shpërndarjet e deklaruara, të paguara ose për t'u paguar).

### **Neni 10** **Zmadhimi i Kapitalit**

- 10.1 Ortakët mund të rrisin kontributin e tyre në kapitalin e Shoqërisë. Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet duke iu ofruar për nënshkrim kuota të reja vetëm ortakëve ekzistues të Shoqërisë në raport të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë ose me zmadhimin e vlerës nominale të kuotave ekzistuese. Kontributet e ortakëve mund të janë në para apo në çfarëdo forme të lejuar nga ligji, duke përfshirë edhe kontributet në natyrë.
- 10.2 Ortakët mund të financojnë shoqërinë nëpërmjet huave, me interes ose pa interes, apo në çdo formë tjetër të lejuar nga ligji, që është e ndryshme nga zmadhimi i kapitalit, në përpjekje dhe me marrëveshjet e ortakëve. Në rastin e financimit të Shoqërisë nga ortakët me anë të një huaje me interes, financimi duhet të miratohet nga Asambleja e Ortakëve me shumicë të thjeshtë.
- 10.3 Mënyra e rritjes së kapitalit (nënshkrimi i kuotave të reja apo zmadhimi i vlerës nominale të kuotave) dhe metodat dhe afatet e pagimit të kontributeve nga ortakët, do të vendoset rasti me Vendim të Asamblesë së Ortakëve. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve mund të përfshijnë ndër të tjera dënimet dhe pasojat për një ortak në rast të mos-pagesës së kontributit të rënë dakord në afatin dhe shumën e caktuar duke përfshirë, po pa u kufizuar, (i) zvogëlimin proporcional të pjesës së ortakut në Shoqëri, (ii) shitjen e detyruar të kuotave të ortakut në Shoqëri, (iii) interes për pagesë me vonesë etj.

- 10.4 Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet edhe përmes nënshkrimit dhe shlyerjes së kuotave të reja të kapitalit nga ortakë të rindj. Ortakët e rindj do të duhet të pranohen dhe miratohen si të tillë me një vendim me shumicë të cilësuar të Asamblesë së Ortakëve.

**Article 11**  
**Zvogëlimi i Kapitalit**

- 11.1 Bazuar në një vendim të Asamblesë së Ortakëve, zvogëlimi i kapitalit mund të kryhet në përputhje me të gjitha procedurat e parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtarë.

**III . STRUKTURA DREJTUESE**

**Neni 12**  
**Asambleja e Ortakëve**

- 12.1 Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë merren me vendim të Asamblesë së Ortakëve, e cila është organi më i lartë i Shoqërisë, që ka të drejtë të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktivitetit të saj.
- 12.2 Çdo kuotë garanton të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme të ortakëve (“**Asambleja e Ortakëve**”), të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë si dhe të drejtat e siguruar nga ky Statut, marrëveshjet midis ortakëve dhe parashikimet e Ligjit Tregtar.
- 12.3 Ortakët mund të rëndojnë me barrë siguruese apo peng tjetër kuotat e tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve, me Shumicë të Cilësuar, duke pasur parasysh se ortaku që është i interesuar në vendosjen e barrës siguruese apo peng tjetër mbi kuotat e tij nuk ka të drejtë vote në këtë rast.
- 12.4 Vetëm Asambleja e Ortakëve do të ketë të drejtë të vendos për çështjet e mëposhtme:
- modifikimin dhe ndryshimin e këtij Statuti;
  - pranimi i ortakëve të rindj (pas zmadhimit të kapitalit apo transferimit të kuotave);
  - të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
  - vendosë për shkrirjen, prishjen, likuidimin dhe çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
  - vendosë mbi blerjen edhe/ose dorëzimin e interesave pjesëmarrëse në shoqëri brenda apo jashtë Shqipërisë;
  - të themelojë dhe/ose mbyll degë dhe përfaqësi jashtë dhe brenda Shqipërisë;
  - të miratojë raportet vjetore dhe bilancet dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit;
  - vendosë rregullat e brendshme të administrimit;
  - të depozitojë padi kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
  - të vendosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pasuritë;
  - të prishë Shoqërinë;
  - të vendosë pagën e Administratorit;

- m. të vendosë për caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- n. të vendosë mbi organizimin strukturor dhe administrative të Shoqërisë;
- o. të vendosë mbi buxhetin vjetor;
- p. të vendosë për çdo çështje tjetër, që i takon për zgjidhje asamblesë së ortakëve, me ligj dhe/ose sipas këtij Statuti.

**Neni 13**  
**Vendimet e Asamblesë së Ortakëve**

- 13.1 Vendimet më sipër, në lidhje me ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimit, organizimin dhe shpërndarjen e Shoqërisë kërkojnë një shumicë të cilësuar prej 3/4 të ortakëve të pranishëm në asamble, në bazë të kërkesave të kuoromit të parashikuara në Nenin 15 më poshtë (“**Shumicë e Cilësuar**”). Të gjitha vendimet e tjera të Asamblesë së Ortakëve mund të miratohen me shumicë të thjeshtë të ortakëve prezent apo të përfaqësuar në asamble, në bazë të kërkesave të kuoromit në Nenin 15 më poshtë (“**Shumicë e Thjeshtë**”).

**Neni 14**  
**Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve**

- 14.1 Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori i Shoqërisë të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në njoftim brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti kalendarik për të miratuar pasqyrat financiare të Shoqërisë të vitit të mëparshëm financiar.
- 14.2 Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të votave të përgjithshme të Shoqërisë mund t'i kërkojnë administratorit me shkrim, duke përfshirë postën elektronike, thirrjen e asamblesë së ortakëve. Kërkesa duhet të mbajë arsyet dhe objektivat dhe çështjet për të cilat asambleja e ortakëve duhet të vendosë. Administratori është i detyruar të mbledhë Asamblenë e Ortakëve në përputhje me Nenin 84 të Ligjit për Shoqërisë Tregtarë, përndryshe ortakët që kanë kërkuar mbledhjen kanë të drejtë ta mbledhin vetë Asamblenë e Ortakëve sipas kërkesave për njoftim të parashikuara në nenin 14.3 më poshtë. Nëse në kundërshtim me këtë dispozitë, Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet, të gjithë ortakët që kanë dërguar kërkesën për mbledhjen e Asamblesë kanë të drejtat e parashikuara nga Ligji Tregtar.
- 14.3 Asambleja e Ortakëve do të thirret me njoftim me shkrim të lëshuar nga Administratori, i cili duhet t'u dërgohet ortakëve apo përfaqësuesve të ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përparrë ditës së caktuar për asamblenë. Njoftimi për ortakët duhet të përcaktojë datën, orën dhe vendin e mbledhjes së asamblesë si dhe çështjet për t'u diskutuar (rendi i ditës) dhe, në rast të një asambleje të zakonshme të ortakëve, duhet të përfshijë pasqyrat e plota financiare dhe raportin e administrimit.
- 14.4 Njoftimet do të janë me shkrim dhe do të dorëzohen me postë me lajmërim marrje ose e-mail në adresat vijuese të Ortakëve ose cdo adresë tjetër të njoftuar rregullisht nga Ortaku përkatës tek Administratori i Shoqërisë:

ANDI PRENGA: “Rr:Kavajes, Kompleksi Delijorgjit, Godina D, NR 3, Prane Kastratit”

ALMA ENESI: "Tuscany Villas, Apartment D8, Lunder, 1001 Tirana"

- 14.5 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër në përputhje me nenin 85 të Ligjit të Shoqërive Tregtare me anë të një prokure.

### **Neni 15**

#### **Vendimet e miratuara ne Asamblenë e Ortakëve**

- 15.1 Në rastin e vendimeve të miratuara me Shumicë të Thjeshtë, Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë prezent ortakët që kanë më shumë se 30% të kuotave të nënshkruara me të drejtë vote. Në rastin e vendimeve që kërkojnë Shumicë të Cilësuar, Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ortakët që kanë më shumë se 50% të kuotave të nënshkruara me të drejtë vote.
- 15.2 Nëse Asambleja e Ortakëve është mbledhur në mënyrë të rregullt, por nuk është mbledhur kuorumi, asambleja e ortakëve do të mblidhet sërisht në përputhje me parashikimet e Nenit 14 por jo më vonë se 30 ditë. Rendi i ditës së asamblesë së dytë nuk do të ndryshojë.
- 15.3 Kur Asambleja e Ortakëve nuk është thirrur sipas formaliteteve të përshkruara në nenin 14 të këtij Statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm dhe shprehen dakord unanimisht për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 15.4 Ortakët mund të marrin vendime me shkrim në mungesë të formaliteteve të parashikuara më sipër në Nenin 15.3 vetëm nëse të gjithë ortakët pranojnë të miratojnë këtë vendim. Për këtë qëllim, të gjithë ortakët mund të nënshkruajnë vendime të ndryshme por analoge (kopje identike), një kopje e nënshkruar e së cilës duhet t'i dërgohet Administratorit të Shoqërisë.
- 15.5 Prosesverbalet e çdo Asambleje të Ortakëve do të mbahen në përputhje me nenin 90 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe nënshkruhet nga ortakët e pranishëm në asamble. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë që procesverbalit të mbahet nga një noter publik në të cilin rast nuk është nevojshme që procesverbalit të nënshkruhet nga ortakët e pranishëm në asamble. Prosesverbalit do të nënshkruhet nga Kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit/noteri publik.

### **Neni 16**

#### **Administrimi i Shoqërisë**

- 16.1 Administrimi i përditshëm i Shoqërisë do të kryhet nga një ose më shumë Administratorë të emëruar me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të emërohet administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.
- 16.2 Administratori mund të shkarkohet vendim të Asamblesë së Ortakëve me shumicë të thjeshtë.

- 16.3 Të drejtat dhe detyrimet e Administratorëve janë ato të përcaktuara në ligj, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

Administratorët kanë të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- a. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe organeve publike;
- b. hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë në banka;
- c. lidhjen e marrëveshjeve me palë të treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
- d. nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë;
- e. mbledhjen e detyrimeve që i takojnë Shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënieve;
- f. punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- g. marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre dhe do të kenë të drejtë të depozitojnë padi apo t'i tërheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje me gjykatën;
- h. ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- i. mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
- j. përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë;
- k. thirrjen e mbledhjeve të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse;

- 16.4 Administratori i parë i Shoqërisë është:

- **Znj. Alma Enesi**, shtetase shqiptare, lindur në Elbasan, më 07.06.1978, mbajtëse e pasaportës nr. BB1445459 dhe me nr. personal H85607058Q, e emëruar për një afat prej 5 vitesh.

#### ***IV. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME***

**Neni 17**  
**Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar**

- 17.1 Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, nëse është e nevojshme.

**Neni 18**  
**Dividentët dhe Fitimi**

- 18.1 Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë të fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë, i cili do të shpërndahet në raport me kuotat e zotëruara në shoqëri dhe në përputhje me nenin 77 të Ligjit për Shoqëritet Tregtar, sipas propozimit të Administratorit të Shoqërisë.

**Neni 19  
Viti Financiar**

- 19.1 Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

**Neni 20  
Bilanci. Mbajtja e Llogarisë**

- 20.1 Bilanci i Shoqërisë kontrollohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tativore përfundimit të muajit Mars të vitit vijues.
- 20.2 Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (lek). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.
- 20.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsyesh Shoqëria mund të vendosë barrë siguruese mbi kuotat si garanci, ose mund të hipotekojë pasurinë e paluajtshme të saj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve të marrë me Shumicë të Thjeshtë.

**Neni 21  
Likuidimi**

- 21.1 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë të prishë Shoqërinë.
- 21.2 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve do të caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të merren me procedurat e likuidimit.
- 21.3 Likuidatori(ët) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një përbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme përfundimin e tij. Në fund të procesit, Asambleja e Ortakëve do të kontrollojë bilancin përfundimtar dhe do të japë miratimin përfundimin e procedurës së likuidimit.

**Neni 22  
Legjislacioni i zbatueshëm**

- 22.1 Çdo gjë që nuk është rregulluar shprehimisht nga ky Statut do të rregullohet nga dispozitat përkatës të Ligjit Tregtar/

**Neni 23**  
**Dispozita Përfundimtare**

23.1 Ky statut është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Nënshkruar në Tiranë, më 27 Shtator 2019 nga:

**ORTAKËT**

**Znj. Alma Enesi**

Alma Enesi  


**Z. Andi Prenga**

Andi Prenga  
